



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



QENDRA KOMBËTARE BURIMORE
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Hapen aplikimet për AKADEMIA E OJF-ve

Akademia e OJF-ve vjen tashmë si një program i konsoliduar, i cili kontribuon në rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të OJF-ve në nivele ekzekutive dhe menaxheriale mbi çështje të zhvillimit dhe menaxhimit organizativ, qëndrueshmërisë financiare, advokimit për çështje të interesit të përbashkët, forcimit të bashkëpunimit ndërsektorial etj. Prej vitit 2015, mbi 90 përfaqësues të OJF-ve shqiptare, me një shpërndarje të gjerë gjeografike, sektoriale dhe përfaqësimi gjinor, kanë përfituar njohuri dhe aftësi në drejtimin dhe menaxhimin efektiv të organizatave të tyre duke i ardhur në ndihmë grupeve të interesit për të cilat janë krijuar dhe publikut të gjerë.

Akademia e OJF-ve 2020 organizohet nga **Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri**, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian, zbatuar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri, në kuadër të komponentit të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të OSHCve në Shqipëri.

Panoramë e Përgjithshme

Organizatave të shoqërisë civile luajnë rol kyç në ndërgjegjësimin dhe edukimin e komunitetit, rritjen e aktivizmit dhe pjesëmarrjes qytetare në politikëbërje, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore e qendrore, si dhe ofrimin e shërbimeve për komunitetet lokale.

Ky rol bëhet akoma më i rëndësishëm në kushtet e zhvillimit të një sërë reformash të rëndësishme që po kalon vendi dhe procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Pavarësisht shtyrjes së hapjes së negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, rekomandimet e vazhdueshme të Komisionit Evropian për anëtarësimin e cilësojnë angazhimin e shoqërisë civile dhe rëndësinë e rolit të saj, në dhënien e kontributit si thelbësor përmes aktivitetit advokues, lobues dhe mbikqyrës në nivel kombëtar dhe lokal për adresimin e një spektri të gjerë çështjesh dhe problematikash në vend.

Për të luajtur një rol më proaktiv në pëmbushjen e funksioneve dhe roleve përmendur si më lart, organizatat jo fitimprurëse ende kanë nevojë për asistencë për zhvillimin dhe konsolidimin e tyre organizativ, ndërtimin e partneriteteve dhe zbatimin e ndërhyrjeve strategjike për të kontribuar qenësishëm në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Të dhënat statistikore të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, tregojnë për një rritje të vazhdueshme të sektorit të shoqërisë civile për nga numri i OJF-ve të regjistruara (vetëm gjatë vitit 2018 janë regjistruar 400 OJF të reja). Kuadri ligjor dhe financiar që rregullon aktivitetin e OJF-ve ka qenë subjekt i ndryshimeve dhe amendimeve të cilat kanë ndikuar në qëndrueshmërinë dhe aktivitetin e organizatave jofitimprurëse si dhe në marrëdhëniet e tyre me shtetin, ndaj njohja e tij nga ana e sektorit mbetet prioritet për të mundësuar një veprimtari efçente.

Akademia e OJF-ve do të:

- Shërbejë si hapësirë e edukimit jo-formal për të përforcuar aftësitë dhe zhvilluar kompetencat e drejtuesve të OJF-ve;
- Rrisë profesionalizmin e këtyre drejtuesve nëpërmjet një kurrikule unike, metodave më bashkëkohore të të nxënies si dhe përvojës profesionale shumëdimensionale;
- Krijojë breza drejtuesish profesionistë dhe të angazhuar, që do të jenë aktorë të ndryshimit dhe kontribues në zhvillimin e shoqërisë Shqiptare.

Akademia e OJF-ve do të zhvillohet në periudhën shkurt-nëntor 2020 dhe do të konsistojë në:

- ✓ **11 leksione** (2 takime në muaj);
- ✓ **përgatitjen dhe prezantimin e detyrave të ndryshme** si: krijimi/ rishikimi i politikave dhe procedurave të brendshme, formateve të raportimit financiar, formateve të projekt propozimeve, planeve për sigurimin e fondeve, mjetet e komunikimit etj.
- ✓ **seanca asistence dhe mentorimi** të hartuara sipas nevojave të pjesëmarrësve më qëllim maksimizimin e nxënies dhe përshtatjes së praktikave të mësuara me nevojat e organizatave.
- ✓ **krijimit të grupeve mbështetëse** (peer coaching) me Alumni të Akademisë- takime të rregullta joformale për të mësuar nga eksperiencat e tyre dhe krijuar mundësi për bashkëpunim midis OJF-ve
- ✓ **pjesëmarrje në vizita studimore** pranë organizatave të shoqërisë civile, komunitetit të donatorëve, sektorit publik dhe privat me qëllim prezantimin e rasteve të praktikave të suksesshme sipas tematikave, ndarjen e eksperiencave dhe modeleve të bashkëpunimit OJF-shtet, OJF-sektori privat, të proceseve me pjesëmarrje, crowd sourcing, ngritjes së fondeve, etj.

Aplikimi

Akademia është e hapur për drejtues të OJF-ve shqiptare në pozicionet: Drejtor Ekzekutiv, Menaxher Programi dhe Kryetar Bordi/Kryesie, të cilët synojnë rritjen e aftësive dhe zhvillimin e tyre profesional në këtë sektor për të ndërtuar organizata efektive në shërbim të publikut dhe grupeve të interesit.

Kandidatët e interesuar për Akademinë e OJF-ve 2020 janë të ftuar të aplikojnë duke plotësuar [Formën e Aplikimit](#). Afati i fundit për dorëzimin e formës së aplikimit është **7 shkurt 2020** ora **17.00**.

Kriteret dhe procesi i përzgjedhjes!

Akademia do të mundësojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sektorit me një shpërndarje të gjerë gjeografike dhe përfaqësim divers nënsektorial.

25 pjesëmarrës do të përzgjidhen për Akademinë e OJF-ve, 2020.

Përdorimi i literaturës, rasteve studimore dhe pjesëmarrja në vizitat studimore do të kërkojnë nivel të mirë njohjeje dhe përdorimi të gjuhës angleze.

Kriteret

Kandidatët do të përzgjidhen bazuar në:

- Motivimin për ndjekjen e Akademisë.
- Lidhjen ndërmjet rritjes individuale profesionale dhe zhvillimit të organizatës që drejton
- Angazhimin për të ndjekur të plotë programin e Akademisë dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve si pjesë e tij.
- Njohjen dhe përdorimin e gjuhës Angleze.

Procesi

- Të gjithë të interesuarit duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë brenda datës 7 shkurt 2020 formën e aplikimit.
- Kandidatët e përzgjedhur do të njofohen brenda datës 17 shkurt 2020. Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të kontaktohen.

Programi

Periudha	Sesionet
21 shkurt 2020	1. Hapja e Akademisë - Tendencat e zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile dhe kuadri ligjor për sektorin e OJF-ve.
mars 2020	2. Anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe roli i OJF-ve në këtë proces. 3. Zhvillimi organizativ dhe qeverisja organizative. Manaxhimi i burimeve njerëzore dhe procedurat e brendshme.
prill 2020	4. Manaxhimi financiar: Buxheti dhe kontabiliteti; Detyrimet dhe raportimet në shtet. 5. Sigurimi i mbështetjes publike dhe puna me sektorin privat. Ngritja e fondeve dhe filantropia
maj 2020	6. Sigurimi i mbështetjes financiare përmes granteve. Shkrimi i projekt-propozimeve dhe manaxhimi i projekteve, grantet e BE-së. 7. Komunikimi strategjik i OJF-ve.
qershor 2020	8. Planifikimi strategjik. 9. Qeverisja me pjesëmarrje.
shtator 2020	10. Mobilizimi i mbështetësve. Krijimi i rrjeteve dhe koalicioneve.
tetor 2020	11. Advokasia dhe lobimi.
korrik– shtator nëntor 2020	* Vizita studimore * Ceremonia e diplomimit.

Për më tepër informacion, luteni të kontaktoni

Znj. Xhoana Zeqo, Koordinatore e Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri,
në info@resourcecentre.al

Shënim: POLITIKA JODISKRIMINUESE E PRANIMEVE NE AKADEMI

Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve Partnerët Shqipëri do të udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit mbi baza gjinore, fetare, etnie apo orientimi seksual.